



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1411/prot.,  
6

Tiranë, më 24.06.2025

**VENDIM**

Nr. 35, datë 24.06.2025

**PËR**

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE NË NEVOJË, QË PËRFITOJNË BURSË PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr.329/141, datë 11.06.2025 “Kërkesë për miratim të listës së studentëve në nevojë, të cilët përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, faza e gjashtë e aplikimeve”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën e 3 (tre) studentëve në nevojë, që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025, faza e gjashtë e aplikimeve, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total është 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**VERA OSTRENI**

**ALBANA GJINOPULLI**

**ALTINA XHAVERI**

**ENDRIT YZEIRAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
ADMINISTRATORI

Nr. 329 / 141 Prot.

Tiranë, më 11 . 06 .2025

**Lënda:** Kërkesë për miratim të listës së studentëve në nevojë, të cilët përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, faza e gjashtë e aplikimeve .

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

E nderuar Kryetare,

Të nderuar Anëtarë të Bordit të Administrimit,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kanë aplikuar për përfitimin e bursës studentore sipas kriterit ekonomik, pranë komisioneve të ngritura në çdo fakultet.

Gjatë kësaj faze kanë aplikuar për përfitimin e bursës studentore 3 studentët, të cilët studiojnë në një program të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Fakulteti    | Studentë që kanë aplikuar gjithsej | Studentë fitues | Studentë jofitues |
|--------------|------------------------------------|-----------------|-------------------|
| FSHMT        | 3                                  | 3               | 0                 |
| <b>TOTAL</b> | <b>3</b>                           | <b>3</b>        | <b>0</b>          |

Dokumentacioni i dorëzuar nga studentët është shqyrtuar nga komisioni përkatës në fakultet. Sa më sipër, rezultojnë 3 studentë në nevojë, të ciklit të parë në Universitetin të Mjekësisë, Tiranë, që plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës studentore për vitin akademik 2024-2025, faza e gjashtë e aplikimeve.

Kriteret që plotësojnë studentët për të përfituar bursën studentore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Fakultetet   | Studentë, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike | Studentë të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë | Gjithsej |
|--------------|--------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| FSHMT        | 2                                                            | 1                                                                                                                                                                                        | 3        |
| <b>TOTAL</b> | <b>2</b>                                                     | <b>1</b>                                                                                                                                                                                 | <b>3</b> |

Efekti financiar për 3 studentë është llogaritur në tabelën e mëposhtme:

| Fakultetet   | Studentët përfitues | Vlera e bursës mujore | Shuma totale e bursave për dy muaj |
|--------------|---------------------|-----------------------|------------------------------------|
| FSHMT        | 3                   | 10,000                | 60,000                             |
| <b>TOTAL</b> | <b>3</b>            | <b>10,000</b>         | <b>60,000</b>                      |

Efekti financiar është 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, llogaritur për 2 muaj dhe do të përballohet plotësisht nga fondet grant të buxhetit të shtetit të shpërndara me grantin e vitit 2025.

Për sa më sipër, i propozojmë Bordit të Administrimit, miratimin e listës me 3 studentë në nevojë, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, faza e gjashtë e aplikimeve.

Bashkëlidhur këtij materiali lutem gjeni:

- Shkresë nr.1673/466 prot., datë 08.05.2025, protokolluar me Tonën nr.329/30 datë 08.05.2025, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,*

**ADMINISTRATOR**  
**ARLIND BROCI**

A circular official stamp of the University of Medicine, Tirana, is visible. The text around the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRIE", "UNIVERSITETI I MJEKËSISË", and "TIRANË". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

ADMINISTRATORI

Nr. 1673/prot.  
466

Tiranë, më 08/05/2025

**Lënda :** Dërgohet lista emërore e studentëve përfutues të bursës, cikli i parë i studimeve Bachelor, për vitin akademik 2024-2025, faza e gjashtë.

**ADMINISTRATORIT TË UMT**

Bashkëlidhur ju dërgojmë listën emërore të studentëve përfutues dhe procesverbalin e shqyrtimit të aplikimeve për bursë, cikli i parë i studimeve Bachelor, viti akademik 2024-2025, për fazën e gjashtë të aplikimeve, nga data 20-27 Prill 2025.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.*

**ADMINISTRATOR****ALKETA MEKAVELATI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I SHKENCËVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. 1673/prot.  
1465

Tiranë, më 08.05.2025

PROCES-VERBAL

**"Mbi fazën e gjashtë të aplikimit për përfitim burse për datat 20.04.2025-27.04.2025"**

I mbajtur sot, më datë 07.05.2025 nga anëtarët e Komisionit të ngritur me Urdhërin e Përbashkët Nr. 83, datë 24.10.2024 me Nr. 1617/1 prot, datë 24.10.2024: *"Për shqyrtimin e dokumentacion-it të studentëve aplikues për përfitim burse për vitin akademik 2024-2025"*, me përbërje si më poshtë vijon:

1. Ines Karapici
2. Adjola Kushova
3. Desara Dosti
4. Ermira Varkova
5. Arkenida Peçaj

Komisioni i sipërcituar shqyrtoi dokumentat e studentëve aplikues për bursë duke u bazuar në kriteret e V.K.M Nr. 39, datë 23.01.2019 *"Për disa ndryshime në vendimin Nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave: "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në tushat prioritare dhe studentët në nevojë"*, i ndryshuar si dhe formatit të miratuar me Vendimin Qarkullues Nr. 15, datë 15.02.2019 të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë *"Për miratimin e formularëve të aplikimit dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet nga studentët që përfitojnë bursë, dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"*.

Sipas Regjistrimit të mbajtur nga Komisioni i ngritur me Urdhërin e Përbashkët Nr. 82, datë 24.10.2024 me Nr. 1617 prot, datë 24.10.2024 *"Për grumbullimin e dokumentacion-it të"*

studentëve aplikues për përfitim burse për vitin akademik 2024-2025", me përbërje si më poshtë vijon:

1. Elda Çelari
2. Marjola Kapllani
3. Fëllanza Allushi

prej datës 20.04.2025 deri më 27.04.2025, u grumbulluan në total 3 aplikime.

Lista me studentët aplikues është verifikuar nga sekretaria mësimore dhe rezulton se nuk ka asnjë aplikant student jo aktiv apo në program të dytë studimi.

Pas shqyrtimit të dosjeve të studentëve aplikues për përfitim burse, Komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacion-it, nga 3 dosje aplikuesish vlerësoi 3 përfitues dhe asnjë jopërfitues.

Sipas viteve të studimit studentët aplikantë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| Cikli i studimit | Viti         | Përfitues | Jopërfitues | Kriter i veçantë | Totali   |
|------------------|--------------|-----------|-------------|------------------|----------|
| Bachelor         | Viti i parë  | 3         | 0           | 0                | 3        |
| Bachelor         | Viti i dytë  | 0         | 0           | 0                | 0        |
| Bachelor         | Viti i tretë | 0         | 0           | 0                | 0        |
| <b>Totali</b>    |              | <b>3</b>  | <b>0</b>    | <b>0</b>         | <b>3</b> |


Sipas kriterëve të aplikimit, për të tre vitet e studimit janë paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

| Kriteri                | Bachelor       |           |             |              |
|------------------------|----------------|-----------|-------------|--------------|
|                        | Nr. aplikimesh | Përfitues | Jopërfitues | Për shqyrtim |
| 1                      | 2              | 2         | 0           | 0            |
| 2                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 3                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 4                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 5                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 6                      | 1              | 1         | 0           | 0            |
| 7                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 8                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 9                      | 0              | 0         | 0           | 0            |
| 10                     | 0              | 0         | 0           | 0            |
| Kriter i paspecifikuar | 0              | 0         | 0           | 0            |
| <b>Total</b>           | <b>3</b>       | <b>3</b>  | <b>0</b>    | <b>0</b>     |

Lista e studentëve fitues është bashkëlidhur shkresës përcjellëse përkatëse.

Pasi lexohet procesverbali firmosei nga të gjithë anëtarët.

#### KOMISIONI:

1. Ines Karapici 
2. Adjola Kushova 
3. Desara Dosti 
4. Ermira Varkova 
5. Arkenida Peçaj (me leje lindje)



FAKULTETI I SHKENCËVE MJEKËSORE TEKNIKE, TIRANË  
LISTA ME STUDENTËT QË PËRFITOJNË BURSE  
FAZA E GJASHTË E APLIKIMIT 20-27 PRILL 2025 DHE E SHQYRTIMIT MAJ 2025

| Nr. | Emër     | Atësi  | Mbiemër   | Programi i Studimit | Viti i Studimit | Kriteri | Kategoria sipas së cilës aplikon                                                                                                                                                        | Statusi   |
|-----|----------|--------|-----------|---------------------|-----------------|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 1   | Amarda   | Eduard | Maho      | Infermieri          | I               | I       | Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike                                                                                                                           | Përfutues |
| 2   | Gisela   | Besnik | Jahollari | Teknike Laboratori  | I               | VI      | Studentët të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë. | Përfutues |
| 3   | Angelina | Fatos  | Rexhmat   | Teknike Imazherie   | I               | I       | Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike                                                                                                                           | përfutues |

*[Signature]*

*[Signature]*